

VENDIM
Nr. 281, datë 6.11.2025

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 176, DATË 29.8.2024, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘ACHELO’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘KOTORRI’ ME KAPACITET TË INSTALUAR 1.9 mw”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2790 prot., datë 5.11.2025, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 29.8.2024, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Achelo’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Kotorri’ me kapacitet të instaluar 1.9 mw””,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Achelo” sh.p.k.

- Shoqëria “Achelo” sh.p.k., me vendimin nr. 176, datë 29.8.2024, është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kotorri” me kapacitet të instaluar 1.9 mw, për një afat 30-vjeçar.

- Në kuptim të sa përcaktuar në pikat 2 dhe 3, të vendimit shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kotorri”, jo më vonë se data 4.8.2025 dhe duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor brenda datës 16.11.2027.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Shoqëria “Achelo” sh.p.k. ka depozituar në ERE raportimet periodike për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Kotorri”, për periudhën maj–shtator 2025.

- Nga shqyrtimi i këtyre raportimeve, evidentohet se shoqëria ka hyrë në prodhim nga data 21 maj 2025.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Për sa përcaktuar në pikën 2, të vendimit nr. 176/2024, rezulton se shoqëria ka filluar ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kotorri”, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të sipërcituar.

- Për pasojë, pika 2 e dispozitivit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 176/2024, vlerësohet të shfuqizohet.

- Gjithashtu, në përmbajtjen e pikës 4 të të njëjtit vendim është konstatuar një gabim material në referencën e brendshme ku në vend që t’i referohej pikës 3 (të cilës i përket afati për depozitim të lejes së rinovuar të përdorimit të burimit ujor), gabimisht i është referuar pikës 2.

- Për pasojë, pika 4 e dispozitivit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 176/2024, vlerësohet të ndryshohet referimi nga pika 2 në pikën 3.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në mbështetje të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se pika 2 e dispozitivit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 176, datë 29.8.2024, duhet të shfuqizohet, pasi shoqëria “Achelo” sh.p.k. ka përmbushur kushtin përkatës dhe duhet të reflektohet situata aktuale e realizimit të projektit.

- Gjithashtu, pika 4, e vendimit nr. 176/2024 përcakton se: “Në rast se shoqëria nuk depoziton lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 dhe ka një

vendim për ndërprerjen/pezullimin e veprimtarisë nga inspektoratet/agjencitë e mbrojtjes së territorit/ mjedisit, atëherë ajo nuk ka të drejtë të operojë/ushtrojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.”.

- Në kuadër të korrigjimit të gabimit material të konstatuar, duhet të bëhet: “Në rast se shoqëria nuk depoziton lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 dhe ka një vendim për ndërprerjen/pezullimin e veprimtarisë nga inspektoratet/agjencitë e mbrojtjes së territorit/mjedisit, atëherë ajo nuk ka të drejtë të operojë/ushtrojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit të ERE-s nr. 176, datë 29.8.2024, shfuqizohet.

2. Pika 4, e vendimit të ERE-s nr. 176, datë 29.8.2024, ndryshohet si vijon:

“Në rast se shoqëria nuk depoziton lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 dhe ka një vendim për ndërprerjen/pezullimin e veprimtarisë nga inspektoratet/

agjencitë e mbrojtjes së territorit/mjedisit, atëherë ajo nuk ka të drejtë të operojë/ushtrojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.”.

3. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “Achelo” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OSSH” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti